



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I MINISTRAVE

PROJEKT VENDIM

Nr. _____, Datë _____.____.2018

“PËR

**PROPOZIMIN E PROJEKTLIGJIT, “PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË
LIGJIN NR.92/2014, “PËR TATIMIN MBI VLERËN E SHTUAR NË REPUBLIKËN E
SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR”**

Në mbështetje të neneve 81, pika 1 dhe 100 të Kushtetutës, me propozim të ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave,

V E N D O S I:

Propozimin e projektligjit, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 92/2014, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, për shqyrtim dhe miratim në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, sipas tekstit dhe relacionit shoqërues që i bashkëlidhen këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E M I N I S T R I

EDI RAMA

MINISTRI I FINANCAVE DHE EKONOMISË

Arben Ahmetaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

PROJEKTLIGJ

Nr. _____/2018, datë ____/____/2018

“PËR

**DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 92/2014 “PËR TATIMIN MBI
VLERËN E SHTUAR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR”**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë,

V E N D O S I:

Në ligjin nr. 92/2014, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

Neni 1

Në nenin 49 “Shkallët e reduktuara”, pas pikës 5, shtohen pikat 6 dhe 7 me përmbajtje:

“6. Shkalla e reduktuar e tatimit mbi vlerën e shtuar, e cila aplikohet për furnizimin e shërbimit të reklamave nga media audiovizive, është 6 për qind.”.

“7. Shkalla e reduktuar e tatimit mbi vlerën e shtuar, e cila aplikohet për furnizimin e mjeteve të transportit publik të udhëtarëve me dhjetë vende ose më shumë, vetëm me motor elektrik, është 10 për qind.”.

Neni 2

Në nenin 51 “Përjashtimi i disa veprimtarive me interes të përgjithshëm”, pas shkronjës “m” shtohet shkronja “n” me këtë përmbajtje:

“n) Furnizimi i makinave bujqësore. Lista e makinave bujqësore përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave”.

Neni 3

Në nenin 53” Përjashtime për disa veprimtari të tjera”, bëhen këto ndryshime:

- Në shkronjën “j” hiqet togfjalëshi ”... dhe nga media elektronike”.

- Pas shkronjës “k” shtohet shkronja “l” me këtë përmbajtje:

“l) Kryerja nga nënkontraktorët e furnizimit të shërbimeve të përpunimit të mallrave jo shqiptare të destinuara për t’u riekportuar, për personat e tatueshem të autorizuar mbi bazën e dispozitave që parashikon Kodi Doganor, për operacione nën regjimin e përpunimit aktiv.

Ministri përgjegjës për financat përcakton me udhëzim dokumentacionin e nevojshëm, për zbatimin e përjashtimit.”.

Neni 4

Në nenin 56 “Përjashtime të veçanta në import”, bëhen këto ndryshime:

- Pika 41, hiqet

- Pas pikës “41”, shtohet pika “42” me këtë përmbajtje:

“42. Importimi i lëndëve të para që përdoren për prodhimin e barnave, me përjashtim të lëndëve me përdorim të dyfishtë, të kryera nga mbajtësit e autorizimit të prodhimit, sipas legjislacionit të fushës për barnat. Lista e lëndëve të para për prodhimin e barnave, përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

Neni 5

Ky ligj botohet në Fletoren Zyrtare dhe hyn në fuqi në 01 janar 2019.

K R Y E T A R I

GRAMOZ RUÇI

